

# dialoguqeveridonatorë

Buletin Informativ – Maj 2011, Botimi nr. 50

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al

Më 13 maj 2011, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Koordinatorja e Përhershme e OKB-së, Zineb Touimi-Benjelloun nënshkruan një projekt të ri që mbështet avancimin e Agjendës Dixhitale të Shqipërisë. Në fjalën e tij në këtë eveniment, Ministri Genc Pollo mes të tjerash theksoi: “Qeveria shqiptare e ka bërë zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (TIK) në një nga prioritetet e saj madhore dhe ka prezantuar projektin Shqipëria Dixhitale, si një iniciativë që do të përshejtojë depërtimin e TIK-ut dhe përdorimin e tij në proceset e qeverisjes në Shqipëri. Arritja e objektivave të “Shqipërisë Dixhitale” do të kërkojë investime në infrastrukturë, reforma institucionale, përmirësime legjislative, forcimin e kapaciteteve dhe mbi të gjitha, zbatim efektiv të këtyre politikave. Projekti do të synojë të përmirësojë edhe themelet juridike dhe teknike të infrastrukturës së TIK-ut. Projekti do t’i japë mbështetje të drejtpërdrejtë Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit që të menaxhojë më mirë agjendën kombëtare të shoqërisë së informacionit. Kjo do të përfshijë asistencë teknike për krijimin e një kuadri ligjor të plotë, forcimin e partneritetit publik dhe privat në këtë fushë si dhe aplikimin në Shqipëri të standardeve më të avancuara”. Koordinatorja e Përhershme e OKB-së dhe Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it vuri në dukje se: “Ky projekt i ri do të mbështesë institucionin e MITIK-ut që të çojë përpara reformat e kërkuara në sektorin e TIK-ut, do të mbështetë Agjencinë Kombëtare të Agjencisë së Informacionit dhe institucione të tjera qeveritare që të fusin dhe të aplikojnë gjithnjë e më tepër shërbime elektronike për qytetarët. Ky sistem do t’i sigurojë vendit një platformë ndërlihdhëse që do t’i ndihmojë shqiptaret të jenë aktorë aktivë në një shoqëri bazuar në dije dhe do të ndihmojë vendin të zhvillojë një ekonomi bazuar në dije”.



Foto: Koordinatorja e Përhershme e OKB-së dhe Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së, Zineb Touimi-Benjelloun, dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Genc Pollo, gjatë nënshkrimit të projektit të ri.

## PNUD rrit mbështetjen për Shqipërinë dixhitale

Mbështetja e PNUD-it do të shkojë edhe për ngritjen e një rrjeti kombëtar me brez të gjerë (*broadband*) që do të rritë konkurrueshmërinë dhe transparencën e Shqipërisë. Projekti do të rritë shërbimet elektronike dhe do të promovojë teknologjitë e reja që sistemet kombëtare dhe vendore të bëhen më të aksesueshme për publikun. Mbështetja në këtë drejtim do të shkojë edhe për ministrinë e linjës dhe organet e qeverisjes vendore, për të

rritur numrin e shërbimeve *online* për qytetarët me qëllim që të rritet cilësia e shërbimeve publike.

Të gjitha këto ndërhyrje do të rrisin ndjeshëm infrastrukturën e TIK-ut dhe shërbimet elektronike të cilat do të zgjerojnë ndërveprimin e shtetit me qytetarët dhe bizneset. Ky projekt është pjesë e programit Një OKB në Shqipëri, i financuar nga Fondi i Koherencës i Kombeve të Bashkuara.

## Në këtë numër

- UNDP rrit mbështetjen për Shqipërinë dixhitale
- Ambasadorët e BE-së të ftuar në emision radiofonik
- Ambasadorja zvicerane viziton zonat dhe popullatën e prekur nga përmbytjet në Shkodër
- Zvicra jep edhe 4.3 milion euro për rritjen e sigurisë së digave në Shqipëri
- Japonia jep pajisje mjekësore për 14 Qendra Rajonale të Urgjencës
- USAID prezanton programin për mbështetjen e arsimit ligjor në Shqipëri
- BE-ja kontribuon në përmirësimin e sigurisë në rrugët e Shqipërisë
- Programi i Përbashkët UNODC-OBSH trajnon praktikuesit për trajtimin dhe kurimin e varësive të evidentuar nga droga
- Programi i USAID në Shqipëri diplomon 14 Aktuarë të rinj
- Seminar për instrumentet financiare në mbështetje të NVM-ve shqiptare
- Prezantimi i veprimtarive të ALCDF
- Barazia gjinore gjithmonë e pranishme në projektet e GIZ-it
- Sistemi tatimor shqiptar dhe efektet e tij në barazinë gjinore
- ILO përkujton Ditën Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- Minatorët e Kukësit mësojnë për të drejtat e tyre mbi sigurinë dhe shëndetin në punë
- Grupi Sektorial i Punës për Ujin diskuton projekt-Strategjinë për Ujësjellës-Kanalizimet



Foto: Ambasadorja gjermane, Shkëlqesia e saj Znj. Carola Müller-Holtkemper gjatë regjistrimit në studio

### Ambasadorët e BE-së të ftuar në emision radiofonik

Ministria e Integritimit me mbështetjen e Projektit “Mbështetje për Ministrinë e Integritimit Europian – SMEI II”, është duke realizuar një program në radio dhe TV të titulluar: “Mirësevini z./ znj Ambasador(e) i...”. Ky aktivitet është pjesë e strategjisë së komunikimit të Ministrisë për informimin e publikut të gjerë rreth aspekteve të Integritimit Europian dhe për nxitjen e ligjëratisë publike mbi këtë proces. Transmetimi i këtij programi nisi më 26 maj dhe e ftuara e parë në studio ishte Ambasadorja gjermane, Shkëlqesia e saj znj. Carola Müller-Holtkemper. Në një atmosferë të këndshme dhe joformale, znj. Müller-Holtkemper bashkëbisedoi me moderatorin e programit, Edi Oga, mbi jetën dhe përvojën e saj në Shqipëri, detyrën zyrtare dhe aspekte të jetës private. Programi në radio është i konceptuar si një bisedë që zgjat rreth 30 minuta e kombinuar me muzikë të përzgjedhur nga secili ambasador. Programi ofron një shumëllojshmëri personalitetesh: të gjithë ambasadorët e Bashkimit Europian të akredituar në Tiranë janë të ftuar si miq, për të folur për vendin dhe jetën e tyre. Bisedën e zonjës Müller-Holtkemper e pasoi ajo me Ambasadorin italian Saba D’Elia, Ambasadorin austriak Florian Raunig, Ambasadorin suedez Patrik Svensson dhe Ambasadorin grek Nicolas Pazios. Kjo do t’i japë audiencës së radios dhe televizionit mundësinë që të mësojnë më shumë rreth Europës dhe aspekteve të jetës në Europë.

Programi në radio dhe TV transmetohet gjatë gjithë verës në këto ditë:

#### Radio – Club FM

- Të enjteve – ora 19:00 (transmetimi i parë)
- Të dielave – ora 23:00
- Të martave – ora 12:00

#### Radio – Club TV

- Të enjteve – ora 19.00 (transmetimi i parë)
- Të shtunave – ora 09.00
- Të martave – ora 16.00

### Ambasadorja zvicerane viziton zonat dhe popullatën e prekur nga përmbytjet në Shkodër

Ambasadorja zvicerane në Shqipëri, Shkëlqesia e saj Yvana Enzler, vizitoi disa periferike të Shkodrës të prekura vjet nga përmbytjet. E shoqëruar nga stafi i Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran dhe në praninë të zyrtarëve të ndërmarrjes së ujësjellësit, Ambasadorja Enzler zhvilloi vizitën më 11 maj dhe u takua me banorët të cilëve u është dhënë ndihmë dhe asistencë zvicerane. Gjatë shpërndarjes së pakove humanitare për rreth 360 banorë, Ambasadorja u takua me familjet rome që jetojnë pranë liqenit të Shkodrës dhe nënvizoi efektet domethënëse që këto nisma kanë për qarkun dhe komunitetin vendor.

Zvicra u përgjigj menjëherë duke kontribuar në emergjencën e përmbytjeve dhe ndihmoi zonat të prekura më rëndë nga përmbytjet. Janë investuar rreth 83 mijë euro për të përmirësuar infrastrukturën dhe konkretisht mbrojtjen për stacionet e pompimit në komunat e Zusit, Bërdicës dhe Oblikës. Për rrjedhojë, 8 600 banorë kanë tashmë lidhje me ujë të pijshëm të pastër dhe të vazhdueshëm. Përveç kësaj, 90 familjeve rome në kushte të vështira je-

tese që u goditën shumë rëndë nga përmbytjet morën paketa me artikuj shtëpiakë dhe sanitarë. Gjithashtu, Zvicra përgatiti një plan veprimi emergjence që do të zbatohet në 8 komuna që në vjeshtën e 2011-ës. Në rrafshin e gjerë, asistencë zvicerane në Shkodër fokusohet në zhvillimin rajonal dhe forcimin e pushtetit vendor.

### Zvicra jep edhe 4.3 milion euro për rritjen e sigurisë së digave në Shqipëri

Qeveria zvicerane, përmes Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) ka miratuar një grant të ri prej 4.3 milion euro në mbështetje të rritjes së standardeve të sigurisë për digat në Shqipëri. Më 24 maj 2011, Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler, nënshkroi marrëveshjen për sigurinë e digave bashkë me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Nasip Naço, Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit, Sokol Olldashi dhe Drejtorin e KESH-it, Engjëll Zeqo.

Zvicra, e cila ka traditë të gjatë në ndërtimin dhe operimin cilësor të digave të sigurta, ka dhënë më parë edhe 1 milion euro për një studim dhe analizim të situatës aktuale të digave mbi lumin Drin dhe Mat, të zonave ujëmbledhëse dhe gjendjes së djefit të poshtëm. Granti i ri do të përdoret për monitorimin e sigurisë së digave, për masa parandaluese për rënien e shkëmbinjve dhe për planet e reagimit ndaj emergjencave. Përveç ngritjes së sigurisë së digave në nivelin e standardeve europiane, granti i ri synon të mbrojtë edhe njerëzit që jetojnë pranë djefit të poshtëm të Drinit dhe Matit. Gjithashtu, granti do të garantojë prodhim të vazhdueshëm energjie nga 5 hidrocentralet që prodhojnë 90% të energjisë në Shqipëri.

Vitet e fundit ka pasur shqetësime serioze për sigurinë e digave në Shqipëri, pasi reshjet e dendura kanë shkaktuar përm-



Foto: Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler, viziton zonat dhe popullatën e prekur nga përmbytjet në Shkodër

bytje në mjaft zona pranë baseneve lumore të Drinit dhe Matit. Me grantin e ri zviceran, pritet që KESH do të instalojë një sistem monitorimi deri në vitin 2014, do të marrë masa për mbrojtjen e infrastrukturës së digave dhe do të ketë plane veprimi të reagimit ndaj emergjencave gati për zbatim.

### Japonia jep pajisje mjekësore për 14 Qendra Rajonale të Urgjencës

Qeveria e Japonisë ka miratuar një grant prej 718 milion jen (ose 6.2 milion euro) për *Projektin për Përmirësimin e Pajisjeve Mjekësore të Qendrave Rajonale të Urgjencës*. Përmes këtij projekti, JICA (Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar) po jep pajisje mjekësore për urgjencë, pajisje të imazherisë, pajisje për laboratorë klinikë, auto-ambulanca dhe pajisje për shpëtimin e jetës në 14 qendra urgjence në të gjithë vendin, me qëllim modernizimin e tyre. Qeveria e Japonisë e miratoi këtë projekt më 2 shkurt 2010. Objektivi kryesor i këtij projekti është të mundësojë diagnostikimin dhe trajnimin e shpejtë në qendrat më afër pacientëve, me qëllim që të përmirësohet indeksi i shpëtimit të jetës në

Shqipëri.

Gjatë periudhës prill-maj 2011, pajisje mjekësore si auto-ambulanca me pajisje të avancuara për shpëtimin e jetës, skanera CT, monitorë të parametrave jetësorë, pajisje imazherie për diagnostikim dhe pajisje të tjera për shpëtimin e jetës, u janë dhuruar Spitalit Pediatrik "Nënë Tereza", Spitaleve Rajonale në Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, dy spitaleve të rretheve Lushnjë dhe Sarandë si edhe si edhe Qendrën Shpërndarëse të Urgjencës Mjekësore në Tiranë. Ceremonitë e dorëzimit u mbajtën në prani të z. Yuzo Ota, Ministër, Ambasada e Japonisë në Shqipëri, z. Satoru Kurosawa, Përfaqësues i Përhershëm i Zyrës së JICA-s në Ballkan, Ministrit të Shëndetësisë, Petrit Vasili dhe përfaqësuesve të tjerë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Këshilli i Ministrave.

### USAID prezanton programin për mbështetjen e arsimit ligjor në Shqipëri

Më 12 maj 2011, USAID dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për ngritjen




Foto: Ceremonia e dorëzimit në Spitalin Rajonal të Kukësit, e mbajtur në prani të z. Yuzo OTA, Ministër, Ambasada e Japonisë në Shqipërisë, Përfaqësuesit të Përhershëm të Zyrës së JICA-s për Ballkanin, Satoru Kurosawa, dhe Ministrit të Shëndetësisë, Petrit Vasili.

e një Programi të Arsimit të Vazhdueshëm Ligjor (AVL) në Shqipëri. Drejtori i Misionit të USAID-it në Shqipëri, z. Joseph Williams dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, z. Maksim Haxhia, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi ku përcaktohen aktivitetet e USAID-it dhe DHKA-së për ngritjen e programit gjatë viteve në vijim. Programi i AVL-së është një komponent i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri dhe do të kontribuojë në forcimin e avokatisë në vend. Programi do të ndihmojë në trajnimin dhe rritjen e standardeve profesionale të avokatëve dhe do të rritë harmonizimin e tyre me standardet europiane. Me mbështetjen teknike të Programit të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST), program i AVL-së do të pilotohet fillimisht në Dhomat Rajonale të Avokatisë në Vlorë dhe Durrës dhe në vijim do të shtrihet në të gjithë vendin deri në vitin 2013.

### BE-ja kontribuon në përmirësimin e sigurisë në rrugët e Shqipërisë

Në maj 2011, Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri (PAMECA III) me buxhet 7 milion euro filloi një seri trajnimesh për edukimin në lidhje me trafikun, ku policë rrugorë bashkë me mësuesit e shkollave do të sensibilizojnë nxënësit e të gjitha shkollave në Shqipëri për rëndësinë e sjelljes së sigurt dhe të përgjegjshme në rrugë. Ky trajnim për edukimin në lidhje me trafikun, që është rezultat i një marrëveshjeje ndërmitore mes Ministrisë së Brendshme



■ Foto: Drejtori i Misionit të USAID-it në Shqipëri, z. Joseph Williams dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë (DHKA), z. Maksim Haxhia, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit ku përcaktohen aktivitetet e USAID-it dhe DHKA-së për ngritjen e programit për arsimimin e vazhdueshëm ligjor (Foto nga: USAID JuST).

dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës bazuar në nismën e PAMECA-s në vitin 2010, do të bëhet pjesë e vazhdueshme e programeve mësimore në mbarë Shqipërinë.

13 policë rrugorë dhe 13 përfaqësues të Ministrisë së Arsimit u trajnuan për një javë në Qendrën e Formimit Policor. Trajnimi për edukatën rrugore u realizua nga policë rrugore ekspertë nga Austria. Më 19 maj, ditën e fundit të trajnimit, u organizuan ushtrime praktike me nxënësit në shkollën publike “Katër Dëshmorët”. Ministri i Brendshëm, Bujar Nishani, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, Shefi i Sektorit Operacional i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Luigi Brusa, Ambasadorja britanike, Fiona McIlwham dhe përfaqësues të tjerë të lartë që morën pjesë në këtë event, theksuan mbështetjen e tyre për këtë edukim të sigurisë publike, duke nënvizuar që kjo do të rezultojë jo vetëm në më pak viktime në rrugët shqiptare, por edhe në rritje të respektimit të shtetit

të së drejtës. Z. Brusa vuri në dukje se “Nga ana e BE-së, ne jemi të lumtur të japim ndihmën tonë për përmirësimin e sigurisë rrugore, për të mirën e këmbësorëve të Shqipërisë, çiklistëve, udhëtarëve dhe shoferëve. Por kjo është një punë në grup - ndihma jonë do të sjellë fryte vetëm nëse fëmijët dhe të rriturit bëhen shoferë, udhëtarë, këmbësorë apo çiklistë të përgjegjshëm.”

Ky trajnim është një kontribut i Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri i realizuar nëpërmjet PAMECA III për të ndihmuar Policinë e Shtetit t’u afrohet standardeve të BE-së. Kjo është hera e parë që është e detyrueshme që Drejtoria e Qarkullimit Rrugor e Policisë së Shtetit dhe mësuesit përkatës të organizojnë në shkollë orë mësimi të përbashkëta për edukatën e qarkullimit rrugor; kjo do të pasqyrohet në programet mësimore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin tjetër akademik. Këto trajnime do të shtrihen në të ardhmen edhe në Policin Rrugore në qarqet e tjera.



■ Foto: Trajnimi i PAMECA-s nëpër shkollë për Sigurinë Rrugore



■ Foto: Trajnimi në terren i PAMECA-s për Sigurinë Rrugore

**Programi i Përbashkët UNODC-OBSH trajnon praktikuesit për trajtimin dhe kurimin e varësisë së evidentuar nga droga**

Më 16-17 maj 2011, në Tiranë u zhvillua trajnimi dyditor për “Analizimi, Vlerësimi dhe Planifikimi i Trajtimin”. Në trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës nga shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor, qendra e toksikologjisë, infermiere shkollash, staf burgjesh dhe OJF. Trajnimin e prezantuan tre trajnues shqiptarë që përfituan nga trajnimi në Zlatibor të Serbisë i financuar nga UNODC/OBSH, të asistuar nga Prof. Raj Boyjoonauth nga Fondacioni NHS në Londër. I gjithë eventimenti dyditor ishte interaktiv, me inskenime situatash dhe veprimtari në grup.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me Modelin e Trajtimin MATRS bazuar në instrumentin ASI (indeksi i shkallës së varësisë). Në fund, trajnuesit dolën në përfundimin që duhet përgatitur një plan ndjekës, me qëllim që të sigurohet përdorim i mirë dhe i vazhdueshëm i instrumenteve të analizës dhe vlerësimit. Formulari që studentët plotësuan tregoi një nivel të lartë të përmbushjes së pritshmërisë së tyre. Ky eventiment me trajnim përfshirës nga trajnerë vendore të motivuar dhe të mirëpërgatitur rezultoi një sukses i vërtetë. Ky trajnim u organizua në kuadrin e zbatimit të Programit të Përbashkët UNODC-OBSH për Trajtimin dhe Kujdesin e Varësisë nga Droga, qëllimi kryesor i të cilit është të promovojë dhe të japë mbështetje mbarëbotërore, me fokus të veçantë shtetet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, për politikën e trajtimit etik dhe të bazuar në evidenca, strategjitë dhe ndërhyrjet për uljen e barrës shëndetësore dhe sociale të shkakuar nga përdorimi i drogës dhe varësia prej saj. Komponenti i forcimit të kapaciteteve të Programit të Përbashkët UNODC-OBSH është zbatuar bashkërisht nga UNODC (Zyra e OKB-së Kundër Drogës dhe Krimin) dhe OBSH. Të dy këto organizata garantojnë përdorimin optimal të burimeve materiale dhe njerëzore që kanë në dispozicion. Këto burime përfshijnë një paketë trajnimit të UNODC të përbërë nga 4 vëllime mbi aspekte të ndryshme të kujdesit dhe trajtimit të varësisë së evidentuar nga droga (përfshi pasojat negative shëndetësore dhe sociale nga abuzimi me drogën, si HIV dhe AIDS) dhe nga një trupë profesionistësh të tra-



Foto: Programi i Përbashkët UNODC-OBSH trajnon praktikuesit për trajtimin dhe kurimin e varësisë së evidentuar nga droga

jnuar nga Europa, që shërbejnë si kryetrajnues për trajnimet në Shqipëri dhe vende të tjera. Paketa trajnuese e UNODC-it është përkthyer në shqip, me qëllim që të sigurohen rezultatet optimale dhe transferimi i duhur i dijeve.

**Rinia diskuton për rolin e saj në përgjigje të sfidave të ndryshimeve klimatike**

Më 3 maj 2011, fëmijët e shkollës “Ylber” në Tiranë, u njohën me sfidat e ndryshimeve klimatike dhe hapat që mund të marrin në mbrojtje të natyrës dhe mjedisit. Drejtoresha e shkollës, Benita Prat Aguirre tha: “Jemi marrë me

ekologjinë duke futur elementë didaktikë në të gjitha lëndët e mësimin: planifikimi shumë i mirë i objektivave, përgatitja e përmbajtjes, strukturës dhe aktiviteteve. Ne duhet të bashkëjetojmë me natyrën. Duhet të mendojmë për planetin që do u lëmë fëmijëve tanë”. Duke reflektuar për përfshirjen e saj në aktivitetet sensibilizuese, Kejsi Progni, nxënëse e klasës të tetë, tha: “Ne folëm për gazrat serë, shkaqet dhe efektet e ngrohjes globale. Jemi fëmijë dhe nuk mund të ndryshojmë fatin e ndryshimeve klimatike apo të shmangim dëmet, por mund të japim ndihmesën tonë në familjet tona për të përmirësuar mjedisin, jetën tonë dhe jetën e brezave që do të vijnë”. Simone Shahini, nxënëse e klasës së pestë që mori pjesë në trajnim, u shpreh: “Është e rëndësishme që



Foto: Nxënësit e shkollës “Ylber” në Tiranë mësojnë për shkencën e ndryshimeve klimatike, gjatë një prej aktiviteteve për sensibilizimin mjedisor.

ta mbrojmë mjedisin. Ne jemi e ardhmja e vendit dhe ndoshta një ditë, efektet e ngrohjes globale do të jenë shumë të mëdha. Ne jemi akoma fëmijë, por mund të bëjmë gjëra të vogla që mund ta ndihmojnë botën, duke u bashkuar të gjithë dhe duke i sensibilizuar të gjithë për këtë çështje”.

Aktivitetet u organizuan me mbështetjen e Programit për Kërkesat e Mjedisit të UNDP-BE për të fuqizuar njerëzit që të bëhen aktorë më aktivë në ruajtjen e mjedisit, përmes promovimit të jetesës së përgjegjshme dhe përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë. Programi po zbatohet në kuadrin e programit Një OKB, komponenti i mjedisit, që synon të përshpejtojë zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor në Shqipëri (objektivi 7 i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit), duke integruar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në programet e politikave kombëtare dhe vendore, duke respektuar njëkohësisht angazhimet e Qeverisë shqiptare në kuadrin e procesit të integrimit evropian. Objektivat specifike të Programit janë: mbështetje për Qeverinë shqiptare që të përmbushë disa kërkesa të caktuara të *acquis* për mjedisin; krijimi i bazës për një mekanizëm formal që mundëson vetëqëndrueshmërinë financiare të aktiviteteve mjedisore; përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje; përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të ujërave në zonat rurale; dhe mbështetja e integrimit të shqetësimeve mjedisore në politikat e tjera sektoriale.

### Programi i USAID në Shqipëri diplomon 14 Aktuarë të rinj

Numri i Aktuarëve në Shqipëri dhe Kosovë po vjen gjithnjë në rritje, e



■ Foto: 14 aspirantë për aktuarë morën diplomë dhe certifikim për t'u licencuar si aktuarë profesionistë për të mbështetur sektorin e sigurimeve dhe atë bankar në Shqipëri (Foto nga: FSVK)

mundësuar kjo nëpërmjet Programit të Trajnimit dhe Certifikimit të Aktuarëve (ATCP) të financuar nga USAID. Më 25 maj 2011, 14 aspirantë për aktuarë morën diplomë dhe certifikim për t'u licencuar si aktuarë profesionistë për të mbështetur sektorin e sigurimeve dhe atë bankar në Shqipëri.

Aktuarët menaxhojnë riskun dhe sigurojnë shërbime të rëndësishme për bankat dhe institucionet financiare jobankare, si edhe garantojnë siguri dhe transparencë shtesë brenda sistemit financiar. Ky program 18-mujor diplomimi u organizua nga Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe Shoqatën e Aktuarëve të Shqipërisë. Ky program u bazua në praktikat më të mira mësimore të Institutit Anglez të Aktuarëve dhe përbëj nga 16 module, me 8 kurse të nivelit fillestar dhe 8 të nivelit të avancuar.

### Seminar për mjetet financiare në mbështetje të NVM-ve shqiptare

Më 19 maj 2011 u zhvillua në Vlorë seminari “Mjetet financiare në mbështetje të NVM-ve shqiptare”, si pjesë e Programit për Zhvillimin e Sektorit Privat të financuar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim. Seminari u hap nga Aldo Sicignano, Drejtor i Kooperacionit Italian për Zhvillim në Shqipëri, Sergio Strozzi, Konsulli i Përgjithshëm në Vlorë, Arben Breshani, Kryetar i Dhomës së Tregtisë në Vlorë, dhe Bashkim Sykja, Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes së Konkurrueshmërisë së Ekonomisë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në seminar morën pjesë përfaqësues të 8 NVM-ve, disa prej tyre nga Fieri dhe Gjirokastra. Seminari



■ Foto 1: Drejtori i Drejtorisë së Mbështetjes së Konkurrueshmërisë së Ekonomisë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Bashkim Sykja, Kryetari i Dhomës së Tregtisë në Vlorë, Arben Breshani, Konsulli i Përgjithshëm në Vlorë, Sergio Strozzi, dhe Drejtori i Kooperacionit Italian, Aldo Sicignano.



■ Foto 2: Eksperti i Kooperacionit Italian për zhvillimin e NVM-ve, Drejtori i Drejtorisë së Mbështetjes së Konkurrueshmërisë së Ekonomisë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Bashkim Sykja, dhe Kryetari i Dhomës së Tregtisë në Vlorë, Arben Breshani.

kishte për qëllim të prezantonte kriteret dhe kushtet kryesore për të përfituar nga dy mjetet financiare të ngritura nga Programi posaçërisht për NVM-të e vogla: një buxhet kreditimi prej 25 milion euro dhe një fond garancie prej 2.5 milion euro. Që nga viti 2009, buxheti i kreditimit ka financuar 48 projekte investim të NVM-ve, me lëvrim total prej rreth 11 milion euro. Faza zbatuese e fondit të garancisë filloi vjet në prill: NVM-të janë ftuar që të aplikojnë për të përfituar nga mundësitë kredituese që ofron ky mjet financiar.

Me rolin e tij si donatori kryesor evropian për zhvillimin e sektorit privat, Kooperacioni Italian promovon në mënyrë aktive këto seminare që të përmirësohet mjedisi i biznesit, të forcohet zhvillimi i NVM-ve shqiptare dhe të rritet konkurrueshmëria e tyre në tregun rajonal dhe evropian. Në seminarin e mbajtur në Vlorë, Kino Buxheli Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Programeve në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe stafi i tij, njohën pjesëmarrësit me procedurat teknike të aplikimit për hua të buta që ofron Programi i Kooperacionit Italian. Gjithashtu, ky eveniment ishte një mundësi për sipërmarrësit që të krijojnë partneritete për bashkim kapitali apo nismash investuese. Pas seminarit, një mision vlerësues i përbërë nga ekspertët të Kooperacionit Italian dhe të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, vizituan tre NVM vendore (Mobileri Serena, Tecnoplast dhe Vlora Alumin), të cilat kanë përfituar nga instrumentet financiare të Programit. Në të tre këto NVM, misioni konstatoi se huat janë investuar pozitivisht për rritjen e kapaciteteve teknologjike.



Foto: Ceremonia prezantuese e aktiviteve të ALCDF

### Prezantimi i veprimtarive të ALCDF

Më 17 maj 2011, Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF) shpalli zyrtarisht fillimin e aktivitetit të tij në Shqipëri. Në këtë ceremoni merrnin pjesë Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, z. Genc Pollo, përfaqësues të lartë të qeverisë, përfaqësues të institucioneve kombëtare dhe vendore, përfaqësues të komunitetit të donatorëve dhe anëtarë të OJF-ve në Shqipëri.

Në fjalën e tij, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, z. Genc Pollo, përgëzoi ALCDF-në që merr nisma të tilla të cilat u mundësojnë komuniteteve rurale të zgjidhin nevojat e tyre më mirë dhe të bëhen partnerë në zbatimin e ideve novatore. Z. Pollo shprehu besimin se ky projekt do të jetë i suksesshëm dhe shtoi se zbatimi i

tij në Shqipëri mund të vlejë si shembull suksesi për vendet e tjera ku ALCDF do ta shtrijë aktivitetin e vet në të ardhmen.

Në këtë ceremoni mbajtën fjalë përsëritëse edhe Ambasadori holandez Henk van den Dool GC, në cilësinë e tij si anëtar i Këshillit të Administrimit të ALCDF-së, Drejtorja Ekzekutive e LEAA-s dhe një nga 6 (gjashtë) bashkëthemeluesit e Fondacionit ALCDF, Valbona Ylli, dhe Drejtorja e SNV-së në Shqipëri dhe Kosovë, Elvana Zhezha. Drejtorja Ekzekutive e ALCDF-së, Lindita Manga dhe Menaxherja e Biznesit e ALCDF-së, Dhurata Thanasi, paraqiten një ekspozitë të aktiviteve të ALCDF-së dhe u shpjeguan pjesëmarrëse se si funksionon portali i ri i ALCDF-së apo siç quhet tashmë PREX Albania, çfarë përfaqëson ky portal dhe se si ekspertiza shqiptare mund të bëhet pjesë e një rrjeti rajonal, kontinental dhe pse jo, edhe global. Të gjitha fazat e regjistrimit në Portalin PREX ALBANIA u prezantuan përmes një prezantimi PowerPoint.

### Barazia gjinore gjithmonë e pranishme në projektet e GIZ-it

GIZ (e njohur më parë si GTZ por që e ka ndryshuar emrin së fundmi) është e angazhuar fuqimisht në mbështetje të barazisë gjinore. Strategjia për Barazinë Gjinore 2010-2014 thekson rëndësinë e kësaj çështjeje dhe e vendos në axhendën e përditshme të të gjitha projekteve. Më poshtë janë dy shembuj projektesh që ilustrojnë përfaqësimin që GIZ ndjek në fokusin e çështjeve gjinore:

“Fondi i Hapur Rajonal për Europën



Foto: Studentët e Juridikut në seminarin Barazia Gjinore dhe e Drejt...

Juglindore – Reforma Ligjore” vjen me komponentin për “Zbatimin Rajonal të Instrumentit për Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve”, në kuadrin e të cilit organizoi një seminar në Fakultetin Juridik të Tiranës. Gjatë semestrit mars-qershor 2011, me një seancë një orë në javë, studentët e juridikut u njohën me aktet juridike kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe u përfshinë në një sërë diskutimesh juridike. Studentët duhej të merrnin pjesë aktivisht duke përgatitur ekspozë dhe/ose tema diskutimi që kishin të bënin me problematikat tipike të çështjeve gjinore. Në këtë kontekst, me rastin e Ditës së Drejtësisë në Shqipëri më 10 maj 2011, studentët përgatitën disa punime artistike që u ekspozuan për 10 ditë në “Hotel de Paris” në Tiranë.

Programi Zhvillimi i Burimeve Njerëzore/Arsimi dhe Formimi Profesional përgatiti një analizë gjinore të vetë programit si edhe të sektorit AFP në Shqipëri. Qëllimi ishte që të kuptohej më mirë mjedisi i përgjithshëm si dhe të përgatiteshin dhe të organizoheshin aktivitetet përkatëse. Është interesante të përmendet që, sipas analizës së hendekut global gjinor të përgatitur nga Forumi Ekonomik Botëror në 2010, Shqipëria konsiderohej se e ka arritur barazinë gjinore në fushën e arsimit (me rezultatin 0.9942, ku rezultati maksimal 1 tregon se është arritur barazia gjinore), ndërkohë që mbetej një hendek i madh në fushën e pjesëmarrjes ekonomike (ku rezultati ishte vetëm 0.6808). Në këtë situatë, është e rëndësishme që sistemi AFP të arrijë standarde të larta dhe nivel të lartë cilësie, pasi këto faktorë kontribuojnë drejtpërdrejt në përgatitjen për tregun e punës.

### Sistemi tatimor shqiptar dhe efektet e tij në barazinë gjinore

Më 22 shkurt 2011, projekti i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Tatimore Suedeze organizoi një seminar pjesëmarrës me nëpunës tatimore, përfaqësues të ministrive të linjës dhe organizata të shoqërisë civile, për të prezantuar dhe për të diskutuar mbi përfundimet dhe rekomandimet e studimit të kryer në kuadrin e projektit “Sistemi tatimor shqiptar dhe efektet e tij të gratë dhe burrat”. Studimi u prit me interes të larta nga pjesëmarrësit dhe raporti përfundimtar ku përfshihen edhe sugjerimet e tyre, pritet të



Foto: Tryeza e rrumbullakët me rastin e Ditës Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

jetë gati për shpërndarje. Raportin mund ta gjeni në faqen zyrtare të [Ambasadës Suedeze në Tiranë](#).

### ILO përkujton Ditën Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Më 4 maj 2011, me rastin e Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, zyra e ILO-s në Shqipëri në bashkëpunimin me Inspektoratin Shtetëror të Punës, organizoi një tryezë të rrumbullakët me titull *Sistemi i Menaxhimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë: Një mjet për përmirësim të vazhdueshëm*. Në eveniment morën pjesë Vikrita Çuto, Inspektore e Përgjithshme e Punës, Zineb Touimi-Benjelloun, Koordinatorë e Përhershme e OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësues e Përhershme e UNDP-së, përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe të Inspektoratit Shtetëror të Punës, si edhe përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve dhe të punëtorëve. Standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë janë një komponent thelbësor i standardeve dhe ligjeve ndërkombëtare të punës. Këtë vit, Dita Botërore e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë u fokusua në zbatimin e një Sistemi Menaxhimi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si një mjet për uljen e incidenteve dhe aksidenteve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Sipas statistikave të ILO-s, çdo vit në mbarë botën ndodhin rreth 337 milion aksidente në vendin e punës, nga të cilat 2.3 milion

përfundojnë me vdekje, ose me fjalë tjera, rreth 6300 vdekje në ditë. Për të garantuar funksionimin efikas të Sistemit të Menaxhimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duhet të instalohet dialog efikas me partnerët socialë, përmes komiteeve të përbashkëta për sigurinë dhe shëndetin në punë, ose përmes marrëveshjeve kolektive.

“Sistemi i menaxhimit për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë zbatimit të masave parandaluese dhe mbrojtëse në vendin e punës, është thelbësor për përmirësimin e kushteve dhe mjedisit të punës”, tha përfaqësuesi i ILO-s në Shqipëri, Alfred Topi. Me pjesëmarrjen aktive të partnerëve sociale, sistemet e menaxhimit për sigurinë dhe shëndetin në punë do të gjejnë zgjidhje praktike për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Inspektorja e Përgjithshme e Punës, Vikrita Çuto, njohu pjesëmarrësit me progresin e bërë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ajo tha se përveç hartimit dhe miratimit të kuadrit ligjor bazë në këtë fushë, është realizuar edhe një fushatë informimi për të rritur sensibilizimin e publikut të gjerë për sigurinë dhe shëndetin. Gjithashtu, është regjistruar një rritje cilësore dhe sasiore aktivitetit të inspektorëve të punës. Përfaqësuesit e partnerëve sociale, punëdhënës dhe punëtorë, mirëpritën masat e marra dhe dhanë sugjerime për përmirësimet të mëtejshme të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Në fjalën e saj, Zineb Touimi-Benjelloun, Koordinatorë e Përhershme e OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësues e Përhershme e UNDP-së, deklaroi angazhimin e agjencive të OKB-së për krijimin e kul-

turës parandaluese për sigurinë dhe shëndetin në punë, e cila varet nga angazhimi, bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta të qeverisë, punëdhënësve, punëtorëve dhe të gjithë aktorëve të tjerë. Znj. Benjelloun-Touimi theksoi qëllimin e saj për të forcuar dialogun për partneritet mes Programit të Bashkëpunimit të OKB-së dhe Qeverisë shqiptare për periudhën 2012-2016, duke komentuar: “Patjetër që do të konsultohemi me ju dhe presim mbështetjen dhe partneritetin tuaj në formulimin dhe zbatimin e dialogut social dhe punësimit.”

Zyra e ILO-s në Shqipëri e përkujton Ditën Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë që nga viti 2003, për të theksuar rëndësinë dhe promovimin e politikave parandaluese për aksidentet dhe sëmundjet në punë, përmes dialogut social dhe bashkëpunimit trepalësh.

### Minatorët e Kukësit mësojnë për të drejtat e tyre mbi sigurinë dhe shëndetin në punë

Minatorët nga fshati Vlahna i Kukësit po trajnohen mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, në kuadrin e Programit të Përbashkët i Një OKB për Rininë, Punësimin dhe Migrimin. 40 minatorë po marrin pjesë në këtë trajnim që po zhvillohet si pjesë e punësimit të tyre në minierën e Vlahnës, pas investimeve të fundit direkte në sektorin e minierave. Trajnimi synon të përmirësojë kushtet e punës dhe sigurinë afatgjatë të punës për komunitetin vendor. Trajnuesi i kursit, Shpend Sokoli, u shpreh: “Në fshatin tonë, gjithkush, sidomos të rinjtë që nuk kanë përvojë pune në miniera, kanë shprehur interes për këtë kurs që të fitojnë njohuri mbi procedurat e punës në miniera”. Më pas ai shtoi se “trajnimi merret me çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të njerëzve që punojnë në miniera si dhe me proceset e punës, në mënyrë që çdo i trajnuar të fitojë njohuri të thelluara për mjedisin dhe kushtet e punës, si edhe informacionin e duhur gjeologjik”. Agron Kaja, një nga 40 pjesëmarrësit në trajnim, tha: “Fshati ynë është shumë i varfër, për shkak të pozitës gjeografike. Megjithatë, fshati është i pasur me minerale, sidomos me krom. Për këtë arsye, burimi kryesor i punësimit dhe i zhvillimit në këtë zonë mbetet industria e nxjerrjes së kromit”. Pastaj ai shtoi: “E kam vlerësuar seriozisht këtë trajnim. Kam arritur të fitoj njohuri se si duhet punuar në miniera.



Foto: Minatorët nga fshati Vlahna në Kukës duke u trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Trajnimi është shumë i dobishëm, sepse është shumë e rëndësishme të dish rreziqet dhe kostot që mbart nxjerrja e mineraleve”.

“Programi i Përbashkët i Një OKB për Rininë, Punësimin dhe Migrimin: vjelja e përfitimeve dhe ulja e risqeve” po zbatohet bashkërisht nga ILO, IOM, UNDP dhe UNICEF dhe synon të promovojë kushtet e denja të punës për të rinjtë dhe menaxhimin e migrimit në Shqipëri, përmes rakordimit më të mirë të strategjive kombëtare për rininë, punësimin dhe migrimin. Programi financohet nga Qeveria e Spanjës përmes Fondit të Arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për Rininë dhe Migrimin.

### Grupi Sektorial i Punës për Ujin diskuton projekt-Strategjinë për Ujësjellës-Kanalizimet

Më 3 maj 2011, grupi sektorial i punës organizoi një takim për të prezantuar dhe diskutuar rreth projekt-strategjisë për menaxhimin e ujësjellës-kanalizimeve. Pas fjalës së hapjes, zv. Ministri i MPPT-së, Ylli Manjani, theksoi se strategjia propozon dhe përpiket të justifikojë komercializimin e sektorit (Tirana, Durrësi dhe Elbasani, aktualisht menaxhohen në nivel pushteti qendror). Rajonalizimi është instrumenti i dytë më i rëndësishëm i strategjisë dhe shtoi se enti rregullator është aktor kyç, pasi do të monitorojë performancën e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. Pas miratimit të strategjisë, KfW do të përgatitë një masterplan dhe do të ndërmerret një reformë

strukturore që të mbulojë fushat si: performanca, standardet, licencimi dhe përmirësimi teknologjik i ndërmarrjeve të ujësjellësit sipas standardeve të BE-së. Aktualisht, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve po përgatit një mekanizëm financimi

Takimi vazhdoi me një prezantim nga z. Zeneli (MPPT) ku përshkroi procesin e hartimit të strategjisë dhe nënvizoi se procesi ishte gjithëpërfshirës. Projekt-strategjia i është dërguar edhe komisionit parlamentar për sugjerime. Më pas, z. Hali, Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës-Kanalizimeve, paraqiti një prezantim mbi situatën aktuale të sektorit. Ai diskutoi rreth performancës së ndërmarrjeve dhe indikatorëve teknikë e financiarë.

Z. Zeneli nënvizoi se çështjet prioritare për burimet ujore që duhen adresuar, janë hartimi dhe miratimi i ligjit të ri për burimet ujore. Gjithashtu, shtoi se duhen forcuar kapacitetet e Sekretariatit Teknik të Këshillave të Baseneve Lumore, dhe se duhet përgatitur plane menaxhimi për të gjashtë basenet lumore, në pajtim me direktivat e BE-së. Përveç kësaj, duhet të garantohet zbatimi në praktikë i Vendimit të Këshillit të Ministrave për mbrojtjes sanitare të burimit sipërfaqësor ose nëntokësor të ujit. Ai gjithashtu trajtoi çështje rregullatore dhe financiare, si zgjerimi i fushës së veprimit të Entit Rregullator të Ujit, sidomos i kompetencave të Entit për të dhënë licenca për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve për publikun, si edhe aplikimi i konceptit të vendimmarrjes vullnetare në nivel pushteti vendor, por me stimuj nga Qeveria qendrore për të inkurajuar pjesëmarrjen e sektorit privat.

## Banka Botërore

Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore, Misioni mbikëqyrës për Përfundimin e Zbatimit dhe Rezultatet, 30 maj - 3 qershor 2011. Objektivi kryesor i misionit ishte vlerësimi i ecurisë së zbatimit të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore në Shqipëri, i cili mbyllet më 30 qershor 2011. Objektivat specifike të misionit ishin: (i) shqyrtimi i stadit të zbatimit të aktiviteteve të Projektit të financuara nga Fondi i Besimit i SIDA-s (i mbyllur më 1 maj 2011) dhe nga kreditimi i IDA-s (që mbyllet më 30 qershor 2011); (ii) diskutimi rreth Fondit të ri të Besimit të SIDA-s; (iii) mbikëqyrja e zbatimit të planeve të menaxhimit për pyjet, kullotat dhe mikro-basenet; dhe (iv) informim për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Projektit.

Projekti për Cilësi dhe Barazi në Arsim, Mision i përbashkët i Bankës Evropiane të Investimeve, Këshillit të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Bankës Botërore, 16 - 23 maj 2011. Një mision i përbashkët i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Bankës Evropiane për Zhvillim, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Bankës Botërore, zhvilluan një vizitë në Shqipëri në datat 16 - 23 maj 2011, për të mbikëqyrrur Projektin për Cilësi dhe Barazi në Arsim, si edhe për të marrë pjesë në takimin 6-mujor për ecurinë e projektit. Gjatë vizitës në Shqipëri, misioni konstatoi ecurinë e përgjithshme të zbatimit si edhe çfarë aktiviteteve pritej të zbatoheshin deri në fund të vitit kalendarik. Fokusi i misionit ishte të përcaktojë me saktësi se cilat aktivitete do të përfundohen deri në datën e mbyljes në dhjetor 2011,

## Misionet në vend

si edhe të parashikojë se çfarë mund të bëhet nëse në harkun kohor prej 6 muajsh. Në këtë kontekst, misioni shqyrtoi progresin e bërë në të gjitha fushat prioritare, si edhe vlerësoi situatën e asistencës grant të dhënë për Instrumentin e Projekteve të Infrastruktura (IPF). Gjithashtu, u vlerësua edhe zbatimi i grantit në kuadrin e IPF-së në lidhje me “metodologjinë e vendimmarrjes për Investimet në Infrastruktura Arsimore”.

Projekti për Reformën në Mjedisin e Biznesit dhe Fuqizimin Institucional (P096643), Misioni Mbikëqyrës, 23

- 27 maj 2011. Objektivat e misionit ishin: (i) takimet me stafin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që punon me projektin BERIS, për të diskutuar rreth ecurisë së deritanishme, planit të prokurimeve, përqindjes së lëvrimeve dhe hapave të nevojshëm për të garantuar mbylljen e suksesshme të projektit deri në janar 2011; takimet me stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për të diskutuar rreth ecurisë së punimeve për ndërtimin e laboratorit të ri të metrologjisë, blerjen e pajisjeve dhe përfundimin e njohurive teknike.

## dialoguqeveridonatorë

Nga data 15 dhjetor 2010 Banka Botërore mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë me se të mirpëritura!

### Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve ([nevila.com@aidharmonisation.org.al](mailto:nevila.com@aidharmonisation.org.al)) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj ([koordinimi@km.gov.al](mailto:koordinimi@km.gov.al)) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

### Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

### Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

### Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo ([nevila.com@aidharmonisation.org.al](mailto:nevila.com@aidharmonisation.org.al))

Buletini “Dialogu Qeveri-Donatorë” mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

